



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:226070

Datë: 18.04.2023

Numri i dokumentit: 04219786

2023:058481

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me procesmbajtësen Edona Salihu, në çështjen penale kundër të pandehurit B.G. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 e me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1655/22, të datës 06.03.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, përfaqësuesit i të ndjerit N.O.1 – vëllait N.O.2, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Admir Salihu, më datë 31.03.2023 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa me datë 03.04.2023 mori dhe publikisht komunikoi, kurse më datë 18.04.2023, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B.G., nga i ati A. dhe e ëma F., e gjinisë S., i lindur më, në Lipjan, me vendbanim në rr. “.....” Ferizaj, banesat e ish-së, kati i parë, hytja e parë nr....., me nr. personal, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datën 01.11.2022. rreth orës 00:02, të mesnatës, në fshatin ..., Komuna e Ferizajt, duke drejtuar automjetin e markës “Audi A4”, me targa, nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 53, 54 dhe 69, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugorë, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që i duke mos ja përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave në rrugë dhe duke garuar me një veturë N.N, e po ashtu duke mos mbajtur distancën anësore të sigurisë, me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit e godet tani të ndjerin N.O.1i cili ishte duke ecur në skaj të rrugës dhe e hedhë mbi xhamin e përparmë të veturës dhe më pas nga forca e goditjes e hedh në tokë, me ç’ rast të dëmtuarit-tani të ndjerit i shkakton lëndime të rënda trupore me rrezik për jetën, plagë të rënda në pjesë vitale të trupit, për çka dhe i njëjti dërgohet për trajtim në Qendrën Emergjente në Ferizaj, me ç’ rast si pasojë e lëndimeve të marra tani i ndjeri N.O.1 nuk arrin ti përballoj plagëve, ku më datën 01.11.2022 në ora 00:25 ndërron jetë dhe sipas Raportit të autopsisë me numër MA22-..., datë 21.02.2023, i hartuar nga mjeku ligjor Dr. N.H., vdekja e të ndjerit është vdekje e dhunshme dhe ka ardhur si rrjedhojë e politraumës, nga shoku hemorragjik-gjakderdhja e brendshme në tru, hapësirat torakale dhe hapësirat e barkut, të cilat lëndime janë shkaktuar nga ndonjë mjetë i fortë dhe i rëndë mbretës siç mund të jetë automjeti.

-me çka ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par. 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës(KPRK-së).

Andaj gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 17, 23, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 370 Kodit Penal të Republikës së Kosovës(KPRK), si dhe në bazë të neneve 364, 452 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK), të pandehurin, e:

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej një (18) muajve, cili dënim me burg nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri brenda periudhës kohore prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale (koha e verifikimi), në të kundërtën dënimi me kusht t’i revokohet. Në dënimin e shqiptuar do të llogaritet edhe koha e kaluar në Paraburgim dhe Arrest Shtëpiak nga data 01.11.2022 e gjerë më datë 10.03.2023.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €uro (tridhjetë euro), si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ €uro, që të dyja shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Refuzohet propozimi i prokurorit të shtetit për shqiptimin e dënimit plotësues: Marrja e lejes së vozitjes.

Ndërsa i shqiptohet dënimi plotësues: Ndalimi i drejtimit të automjeteve në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili fillon të ekzekutohet pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Përfaqësuesi i të ndjerit N.O.1, vëllau N.O.2 nga Ferizaj, rruga “.....” nr., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1655/22, të datës 06.03.2023, ndaj të pandehurit, për shkak se ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6, lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 31.03.2023, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seance kane prezantuar prokurori i shtetit, Përfaqësuesi i të ndjerit N.O.1- vëllau N.O.2 dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij me autorizim.

Në fillim të shqyrtimit fillestar gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tij në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së. Dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe është konsultuar mjaftueshëm me avokatin e tij,

në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se, e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare, me vjen keq që ka ndodhur aksidenti, i kërkoj falje publike dhe i shpreh ngushëllime palës së dëmtuar i cili është prezent në këtë shqyrtim fillestar.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar në pajtim me nenin 242 par. 5 të KPPRK-së, ka kërkuar mendimin e prokurorit të shtetit, Përfaqësuesit të të ndjerit si dhe të avokatit mbrojtës të pandehurit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar, pasi që i pandehuri u konsultua paraprakisht me mbrojtësin e tij lidhur me pranimin e fajësisë për veprën penale që e ngarkon akuza dhe duke i kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë dhe i propozoj gjykatës që të pandehurit ti bëhet pranimi i fajësisë. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata të marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPPRK-së posaçërisht peshën e veprës penale duke pasur parasysh faktin se si pasojë e veprimeve të pandehurit në komunikacion ka vdekur edhe tani i ndjeri N.O.1. Po ashtu faktin se i njëjti nuk ka qenë i kujdesshëm gjatë vozitjes së automjetit të tij dhe nuk i ka përshtatur kushtet dhe rrethanat respektivisht shpejtësinë e lëvizjes, për pasojë ka shkaktuar aksident në komunikacion me pasojat e që është vdekja. Po ashtu gjykatës i propozojmë që në kuptim të nenit 59 par.2 nënpar.2.6 dhe nenit 65 par.1 të KPPRK-së të pandehurit të i shqiptohet dënim plotësues dhe atë marrja e lejes së vozitjes dhe të i ndalohej të pandehurit që për dy vite të mos mund të pajiset me leje të re të vozitjes siç është propozuar në këtë aktakuzë.

Përfaqësuesi i të ndjerit N.O.1- vëllau N.O.2, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale pasi që rasti ka ndodhur nga pakujdesia e të pandehurit dhe të njëjtit siç ne i kemi adetet tona kanë ardhur edhe në varrim të ndjerit dhe për rastin jemi marrë vesh edhe familjarisht, kurse sa i përket kërkesës pasurore juridike atë do ta realizojmë në kontest civil.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Admir Salihu lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar, duke i analizuar të gjitha rrethanat në veçanti raportin e ekspertizës së komunikacionit konsiderojmë që pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është konform ligjit dhe i kërkojmë gjykatës që të njëjtën ta pranojë e që e njëjta është bërë me vullnetin e lirë pas njoftimit nga ana e avokatit për beneficionet dhe pasojat, andaj konsiderojmë që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që të pranohet fajësia për veprën penale që i vihet në barrë, duke menduar që jeta e një njeriu shpesh herë dhe në të gjitha rastet është më e rëndësishme se e drejta e personit të gjallë andaj edhe gjatë shqiptimit të dënimit lusim gjykatën të marrë parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese e që janë pendimi i thellë, pranimi i fajësisë, raporti me palën e dëmtuar, përgjegjësia që është përcaktuar në ekspertizë për të akuzuarin dhe të ndjerin, të gjitha këto rrethana lusim gjykatën të i ketë parasysh meqë i akuzuari asnjëherë nuk ka rëndësuar me ligjin dhe kjo vepër penale i ka shkaktuar dhimbje shpirtërore dhe i njëjti do të jetojë me brengën dhe me përgjegjësinë për veprën që i ka ndodhur dhe me rrethanat që kanë ndodhur i njëjti duhet të ballafaqohet me to.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë, Raporti mjekësor me nr. të protokollit ..., në emër të N.O.1 e datës 01.11.2022, Dëshmia e dëshmitarit P.A. e dhënë në Polici me datën 01.11.2022, Deklarata e përfaqësuesit të të ndjerit N.O.1, N.O.2 të dhënë në Polici me datë 11.11.2022, Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit rrugorë e përgatitur nga inxhinieri Xh.M. e datës 16.11.2022, Raporti i autopsisë për të ndjerin N.O.1 e përpiluar nga ekspertja mjekoligjore Dr. N.H. me nr. të ref.MA22-..., të datës, 21.02.2023, Raporti i aksidentit nr.2022-CFT-.. e datës 01.11.2022 së bashku me skicën e vendit të ngjarjes, video CD-e me pamje nga vendi i ngjarjes pak para se të ndodh aksidenti, Kopja e librezës së qarkullimit të automjetit CRA si dhe fotot e bëra në vendin e ngjarjes.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka

vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe iu shqiptua dënim me kusht dhe dënimi plotësues siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana veçanërisht lehtësuese përkatësisht që në shqyrtimin fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimin e sinqertë të tij për veprën penale të kryer, kërkim faljen publike, se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, se përfaqësuesi i të ndjerit nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, ndërsa në rastin konkret nuk si rrethanë rënduese gjeti se si pasojë e kësaj veprë penale ka humbur jetën një njeri dhe përveç kësaj vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënime të tilla, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi udhëzimin e Përfaqësuesit të ndjerit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par.
1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3
pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL
2023:058481 e datës 18.04.2023

Procesmbajtëse
Edona Salihu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në
Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit
të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe
Gjykatën.